



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:070958

Datë: 28.01.2021

Numri i dokumentit: 01449849

C.nr.1019/20

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm- gjyqtari Habib Zeqiri, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditëses R.V., të cilën e përfaqëson av.Nezir Bytyqi, kundër të paditurës Komuna e Ferizajt-Drejtoria për Arsim, në çështjen juridike kërkesa për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, jashtë seancës së shqyrtimit gjyqësor më 28 janar 2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET si e themeltë kërkesëpadia e paditëses R.V. nga Ferizaj rr. ‘‘.....’’ nr.,, ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Ferizajt-Drejtoria për Arsim, në emër të shpenzimeve të ushqimit t’i paguaj paditëses shumën prej 368.00 € (treqind e gjashtëdhjetë e tetë euro) për periudhën kohore nga data 18 prill 2017 deri më 02 shkurt 2018 me kamatë ligjore prej 8% nga dita e marrjes këtij aktgjykimi deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 98.00 € (nëntëdhjetë e tetë euro) të gjitha brenda afatit prej 7 dite nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, në të kundërtën ky aktgjykim do të ketë karakterin e titullit ekzekutiv dhe mund të përmbarohet menjëherë.

A r s y e t i m i

Paditësja R.V., përmes të autorizuarit së tij av. Nezir Bytyqi, më datë 18 qershor 2020 në këtë gjykatë ka paraqitur padi, me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura-Komuna e Ferizajt-Drejtoria për Arsim, që në emër të shpenzimeve të ushqimit ti paguaj shumën prej 368.00 €.

E paditura, më 29 shtator 2020, ka paraqitur përgjigje në padi, përmes së cilës nuk i ka mohuar faktet e paraqitura me padi nga ana e paditësit, mirëpo e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit nga fakti se duhet shikuar edhe mundësia financiare për përmbushjen e detyrimeve të tilla.

Gjykata pa caktuar seancë gjyqësore, pas shqyrtimit të padisë, shkresave të tjera të lëndës, përgjigjen në padi të paraqitur nga ana e të paditurës në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, respektivisht në Shkollën Fillore e Mesme e Ulët "....." në Ferizaj.

Gjykata me rastin e vendosjes (jashtë seancës gjyqësore) është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Referuar dispozitës të cituar si më lartë, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, sepse kërkesëpadia e paditësit ishte qartazi e themeltë dhe se kundërshtimi i të paditurës, konsiderohet sipërfaqësor dhe gjuhësor kur thuhet se kundërshton kërkesëpadinë e paditësit dhe se kundërshtimi nuk ishte real dhe thelbësor. Çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës është natyrës teknike, andaj gjykata ishte e bindur në mënyrën e vendimmarrjes, e që natyrshëm përveç qartësisë së kërkesëpadisë, gjykata i referohet edhe parimeve të procedurës civile, të normuara në nenin 10 par.1 të LPK-së, në të cilën dispozitë përcaktohet që çështja duhet trajtuar pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzime.

Lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë, e njëjta ka rezultuar të jetë e bazuar në bazë të Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë në 24 të datës 18.04.2017, e nënshkruar mes Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) me anë të cilës, mes tjerash, punëdhënësi (në këtë rast Drejtoria Komunale e Arsimit-Komuna e Ferizajt) konkretisht neni 35 paragrafi 7 dhe 8 i kontratës.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e mbështeti në nenin 452 të LPK-së, e që e paditura është obliguar që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 98.00 €, dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumë prej 78 € (sipas rregullores mbi tarifatat e OAK-së në fuqi) kurse në emër të taksës gjyqësore për padi shumë prej 20 €.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi .

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,
C.nr.1019/20, me datën 28 janar 2021

Gjyqtari
Habib Zeqiri

KESHILLA JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 7 (shtatë) dite, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Kosovë, përmes kësaj gjykate.